

**Ministri i Shtetit**

SACHSISCHES STAATSMINISTERIUM FÜR KULTUS  
(MINISTRIA SHETERORE SAKSONE E KULTURËS)  
Kutia Postare 10 09 10 | 01079 Dresden

Për të gjithë prindërit  
e nxënësve  
të shkollave publike  
në Shtetin e Lirë të Saksonisë  
(Sachsen)

Dresden, 28 gusht 2020

Për informacion:  
Për të gjithë prindërit  
e nxënësve  
në shkollat e pavarura

Të nderuar zonja dhe zotërinj! Të dashur prindër!

pushimet verore mbaruan - një vit i ri shkollor po fillon. Viti shkollor 2020/2021 do të shoqërohet prej sfidave të veçanta. Dëshiroj t'ju bëj një përmbledhje, se si do të funksionojë shkolla për ju dhe fëmijët tuaj në kushtet e pandemisë.

Ju e dini, sa e rëndësishme është shkolla. Për fëmijët tuaj, shkolla është një vend për të mësuar dhe jetuar, ku shoqërohen me të tjerë, takohen me shokë e shoqe, mësojnë dhe zhvillojnë aftësi shoqërore. Fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për një strukturë ditore dhe normalitet. Ata kanë të drejtën për t'u arsimuar, të drejtën për mënyrën më të mirë të mundshme të përvetësimit të dijes dhe të zhvillimit të aftësive, dhe ata kanë nevojë për shokët dhe shoqet e tyre. Jam i bindur se kjo mund të arrihet plotësisht vetëm përmes mësimit të përditshëm në shkollë.

Që para pushimeve të verës, unë kam njoftuar, se të gjithë nxënësit do të marrin mësim në klasat dhe kurset e tyre pesë ditë në javë, sipas orareve dhe programeve mësimore në fuqi. Qëllimi ynë është që mësimi të bëhet sa më normal dhe që kufizimet për nxënësit t'i reduktojmë sa më shumë të mundemi. Mbyllja e shkollave në rast të rritjes së shkallës së infeksionit, duhet të jetë masa e krejt fundit - vetëm zgjidhja e fundit.

Parimisht, ndjekja rregullisht e shkollës është e detyrueshme. Mospjesëmarrja e një nxënësi apo nxënëseje në mësim për shkak të një rreziku të rëndë shëndetësor lejohet vetëm përmes një atesti mjekësor, i cili duhet t'i paraqitet shkollës. Këta nxënës pastaj do të pajisen me materiale për kohë mësimore në shtëpi.

Që mësimi të fillojë sërish rregullisht në të gjitha shkollat e Shtetit të Lirë Sachsen, duhet që të vazhdohet të respektohen rregullat e higjenës që janë ushtruar mirë deri tani. Shkolla juaj do t'ju informojë mbi konceptin e higjenës së vet të bazuar në planin e përgjithshëm të higjenës.



Adresa e institucionit:

**Sächsisches Staatsministerium für  
Kultus**  
Carolaplatz 1  
01097 Dresden  
[www.smk.sachsen.de](http://www.smk.sachsen.de)

**Lidhja me mjetet e transportit:**

Mbërritja me linjat e tramvajit 3, 7, 8

Informacione rreth aksesit tek dokumentet e nënshkruara elektronikisht si dhe tek dokumentet e koduara elektronikisht mund t'i gjeni në faqen [smk.sachsen.de / kontakt.htm](http://smk.sachsen.de/kontakt.htm)

Këtu dua të theksoj vetëm disa rregulla kryesore:

- Në shkollë nuk lejohet të hyjnë persona që janë të infektuar me SARS-CoV-2 ose kanë simptoma që indikojnë për të (kollë, temperaturë, diarrë, të vjella).
- Nëse një nxënës shfaq simptoma të SARS-CoV-2 për më shumë se dy ditë rresht, hyrja në shkollë lejohet vetëm dy ditë pas shfaqjes së simptomave për herë të fundit.
- Kushdo që hyn në shkollë, duhet të lajë mirë ose t'i dezinfektojë duart menjëherë.
- Klasat dhe dhomat që përdoren rregullisht duhet të ajrosen disa herë në ditë.

Nxënësit duhet të mbajnë maskë gjatë udhëtimit me mjetet e transportit publike, po ashtu edhe në autobusin e shkollës. Drejtori/drejtoresha e shkollës përcakton brenda kuadrit ligjor të institucionit të tij, se në cilat situata duhet të mbahet maska në ndërtesën ose oborrin e shkollës. Një mësim i mirë kërkon komunikim të mirë, reagime me mimikë dhe përqendrim të plotë. Kjo bëhet shumë e vështirë, kur mbahet maska me orë të tëra në ditë. Prandaj, nxënësit dhe mësuesit mund të mbajnë një maskë të tillë mbrojtëse gjatë orës së mësimit vetëm me dëshirë dhe për arsye krejt personale.

Drejtorët/drejtoreshat e shkollave, së bashku me stafin e tyre mësimdhënës, e kanë përgatitur mirë vitin shkollor 2020/2021. Përveç detyrave të tyre të shumëllojshme dhe të ngarkuara - ata duhet të marrin vendime edhe në lidhje me organizimin e shkollës gjatë periudhës së koronës. Për shkak të kushteve të ndryshme në lidhje me stafin dhe hapësirat, shumë gjëra mund të projektohen më mirë në detaj vetëm direkt në vend. Lutemi të ndiheni të sigurtë dhe të tregoni besim, se kjo bëhet për të mirën e fëmijëve tuaj.

Gjatë mësimit të rregullt, distanca prej 1.5 m në klasë nuk mund të mbahet. Unë e kuptoj, se një pjesë e prindërve, nxënësve dhe mësuesve janë të shqetësuar ose shumë të shqetësuar për këtë situatë mësimi. Studimet e spitaleve universitare Dresden dhe Leipzig në Sachsen kanë treguar pavarësisht nga njëri-tjetri, se as para izolimit ose pas rihapjes së tyre, shkollat nuk janë shndërruar në qendra infeksioni dhe se fëmijët kanë qenë pak të prekur nga infeksioni. Hulumtimet vazhdojnë ende. Unë dua t'ju siguroj që ne do të vazhdojmë të ndjekim me vëmendje si zhvillimin e infeksionit ashtu edhe të rehat shkencore. Edhe në të ardhmen ne do të vazhdojmë të marrim vendime të peshuara dhe të përgjegjshme.

Numri i infeksioneve aktualisht është në një nivel shumë të ulët, por edhe në Shtetin e Lirë të Saksonisë (Sachsen) nuk mund të vlerësohet akoma se si do të rrjedhin muajt e ardhshëm. Ne duhet të përgatitemi që infeksionet mund të marrin hov përsëri - këtu nuk përjashtohen as shkollat. Për masat e veçanta në mbrojtje të popullsisë ndaj infeksionit vendosin autoritetet lokale shëndetësore të rretheve ose qyteteve. Pavarësisht nga numri i përgjithshëm i rasteve, autoritetet shëndetësore do të vendosin, nëse do të mbyllen shkollat për 14 ditë kur infeksionet përqendrohen në një institucion ose në objektet fqinje (pika të nxeha lokale).

Në rast të kufizimi i mësimit në prezencë apo edhe mbyllja lokale e shkollave bëhet e domosdoshme, mësuesit tashmë janë të përgatitur që nga fillimi për këtë rast.

Ministria Shtetërore e Kulturës dhe Zyra Shtetërore për Shkollat dhe Arsimin kanë forcuar shërbimet dixhitale qendrore të Shtetit të Lirë të Saksonisë (Sachsen) dhe do të vazhdojnë t'i zhvillojnë ato. Materiale arsimore shitesë, si p.sh. fletë pune dixhitale, filma interaktivë, materiale për përgatitjen e mësimit janë vënë në dispozicion. Ne kemi zgjeruar gamën e informacionit, trajnimit dhe mbështetjes për mësimit dixhital - edhe në distancë - dhe do të vazhdojmë ta zhvillojmë atë.

Të dashur prindër,

unë jam i vetëdijshëm që shumë nxënës, si dhe mësues dhe prindër janë të shqetësuar për rrugën e mëtejshme të arsimimit. Mësimi në shtëpi tregoi rezultate shumë të ndryshme - për arsye nga më të ndryshmet - dhe nuk mund të zëvendësojë mësimit ballë për ballë. Prandaj jo i gjithë plani mësimor arriti të mbulohej në gjysmën e fundit të vitit shkollor. Në përgatitje të vitit të ri shkollor, në të gjitha shkollat u regjistruan nivelet mësimore individuale në lëndët e veçanta. Mësuesit dhe mësueset në këtë vit shkollor do ta përshtasin shpërndarjen e materialit në atë mënyrë që t'i trajtojnë temat mësimore më kryesore. Lutem të mirëkuptoni se prioritetin më të madh në jetën shkollorë e kanë për momentin mësimit i detyrueshëm dhe në prezencë.


Informacione të hollësishme dhe të mëtejshme për pyetjet në detaj i gjeni në faqen tonë të internetit në [www.bildung.sachsen.de/blog](http://www.bildung.sachsen.de/blog). Nëse këtu nuk gjeni përgjigje për pyetjet tuaja, ju lutemi kontaktoni Ministrinë Shtetërore të Kulturës ose Zyrën Shtetërore për Shkollat dhe Arsimin. Për pyetje konkrete, pika e parë e kontaktit është shkolla juaj.

Viti shkollor 2020/2021 do të shoqërohet prej sfidave të veçanta. Ju lus që të keni besim tek aftësitë pedagogjike dhe tek instikti i mësuesve tanë.

Fëmijët tanë kanë nevojë gjithmonë për vëmendjen dhe kujdesin tonë. Në periudhën e koronës kjo do të thotë edhe për të gjithë ne: Respektim i rregullave të përgjithshme të higjienës. Le të zvogëlojmë kontaktet shoqërore të panevojshme dhe, mbi të gjitha ato të papeshuara mirë. Ju lutemi mbani distancë ju, në mënyrë që fëmijët tanë të mos kenë nevojë.

Ju uroj juve, familjes suaj dhe veçanërisht nxënësve tanë një fillim të mbarë dhe një vit të suksesshëm shkollor!

Me nderime,



Christian Piwarz